

VENDIM
Nr.13, datë 10.6.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjolla Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 1.3.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.22 Akti që i përket:

KËRKUES: ELIS BRAHIMAJ, përfaqësuar nga avokatët Hekuran Skuqi e Blerina Muça, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga Skënder Breca, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.565, datë 10.11.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, ka parashtruar këto shkaqe:

- Nuk ka pasur dijeni për rekursin e paraqitur nga prokuroria e as për datën e shqyrtimit të tij, për këto arsye nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes.

- Gjykata e Lartë duhej të caktonte një mbrojtës, përderisa ai, Elis Brahimaj ka qenë i mitur, kërkesë e domosdoshme e nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesin e kërkuesit, të subjektit të interesuar, dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi Elis Brahimaj, i datëlindjes 26 prill 1988, është dënuar, sipas nenit 283/2 të Kodit Penal, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me 2 (dy) vjet burgim, për veprën penale të shitjes së lëndëve narkotike në bashkëpunim, dënim i pezulluar me kusht. Këtë vendim Gjykata e Apelit Durrës e ka lënë në fuqi me vendimin nr.336, datë 8.12.2003.

Gjykata e Lartë ka shqyrtuar çështjen në bazë të rekursit të prokurorit dhe me vendimin nr.565, datë 10.11.2004 ka ndryshuar dy vendimet e mëparshme duke i shfuqizuar ato, përse i përket pezullimit të ekzekutimit të dënimit. Në Gjykatën e Lartë, gjykimi është bërë me pjesëmarrjen e prokurorit, por pa praninë e kërkuesit dhe mbrojtësit të tij.

Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në dosje rezultoi se në të ekziston një dëftesë komunikimi e rekursit nënshkruar nga avokat Niko Duro, i cili ka qenë mbrojtësi i kërkuesit në hetim, në gjykimin në gjykatën e rrethit dhe në atë të apelit. Në dosje ndodhet gjithashtu një deklaratë nënshkruar nga kërkuesi dhe avokat Niko Duro, sipas të cilës, Elis Brahimaj, kërkonte që gjykimi në gjykatën e apelit të bëhej pa praninë e tij, e në prani të avokatit të lartpërmendur, të cilin e ngarkonte me përfaqësim në të gjitha shkallët e gjykimin.

Fakt është se, megjithëse data e gjykimin të çështjes në Gjykatën e Lartë është shpallur, avokati në mbrojtje të kërkuesit ka munguar në gjykim dhe nuk është caktuar avokat tjetër.

Në nenin 49 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar shprehimisht: “Kur i pandehuri është nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, ..., ndihma nga një mbrojtës është e

detyrueshme”; kurse në pikën 5 të po kësaj dispozite, parashikohet se “... kur kërkohet prania e mbrojtësit dhe kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori cakton si zëvendës një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit”.

Sipas dispozitave të përmendura del e qartë se në gjykimin e të miturve mbrojtja është e detyrueshme dhe se mungesa e saj, në bazë të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale, i bën aktet procedurale absolutisht të pavlefshme e për pasojë, gjykimin antikushtetues. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të përmendura më lart, përbëjnë garanci për zbatimin në këtë fushë të nenit 54 të Kushtetutës, i cili parashikon për fëmijët një mbrojtje të veçantë nga shteti, krahas disa subjekteve të tjera.

Për çështjen në shqyrtim, rëndësi të veçantë merr diskutimi dhe zgjidhja e problemit nëse dispozitat e mësipërme procedurale do të zbatohen në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë. Në lidhje me këtë, përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, shfaq mendimin kategorik se këto dispozita nuk zbatohen në Gjykatën e Lartë si një gjykatë që merret me kontrollin e zbatimit të ligjit.

Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë, krahas parimeve të tjera, është e detyruar të respektojë kontradiktoritetin e barazisë e palëve në gjykim. Zbatimi i këtyre parimeve në gjykimin penal kërkon që i pandehuri, i mitur, nëpërmjet mbrojtësit të tij, të paraqitet e të dëgjohet njëllë si prokurori. Zbatimi me korrektësi i këtyre parimeve do të përjashtonte disavantazhin e një pale ndaj tjetrës. Në çështjen konkrete, nga Gjykata e Lartë, i ka shkelur parimet edhe pse shqyrtohej një rekurs që, nëpërmjet ndryshimit të vendimeve të shkallëve të tjera të gjyimit, rëndonte pozitën e të pandehurit të mitur.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, për shkak të moszbatimit të principeve themelore të gjyimit, e vlerëson vendimin nr.565, datë 10.11.2004 të Gjykatës së Lartë antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në neve 72 e 77 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.565, datë 10.11.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.